



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT
KËSHILLI I FAKULTETIT
Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 1 - Tiranë
Tel. & Fax.: 00355 42 278 159

Tiranë, më 27.10.2014

V E N D I M

Nr. 19, datë 27.10.2014

mbi

"Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programet e studimit me kohë të plotë të ciklit të dytë, "Master i shkencave" dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve fitues në programet e studimit me kohë të plotë të ciklit të dytë "Master Profesional", në FTI, viti akademik 2014-2015"

Mbështetur në ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 18, në Statutin e UPT, neni 23, në Rregulloren mësimore të UPT, neni 11, në Rregulloren e FTI, neni 14, si dhe në vijim të Vendimit Nr. 668, datë 15.10.2014 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, për programet e studimeve të Ciklit të Dytë me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", për vitin akademik 2014-2015", në zbatim të Udhëzimit Nr. 46, datë 20.10.2014 të MAS "Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në Ciklin e Dytë të studimeve me kohë të plotë, "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave", në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2014-2015", Këshilli i Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në mbledhjen e tij të datës 27.10.2014, ku morën pjesë 10 anëtarë nga 11 gjithsej, me unanimitet,

vendosi:

Kriteret e përcaktuara për kandidatët që aplikojnë për programet e studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" në FTI janë:

1. Studentët e diplomuar në FTI duhet të kenë mesatare të ponderuar ≥ 7.00 .
2. Studentët e diplomuar në UPT, në degë ekuivalente duhet të kenë mesatare të ponderuar ≥ 8.00 .
3. Studentët e diplomuar jashtë UPT, FTI, në degë ekuivalente duhet të kenë mesatare të ponderuar ≥ 8.50 dhe pikë nga Matura Shtetërore sa minimumi i pikëve të pranimit në FTI, në vitin përkatës.

Procedurat e pranimit për kandidatët që aplikojnë për programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" në FTI janë sipas Rregullores së pranimeve në secilin program studimi, të miratuara nga departamentet përkatëse.

Ngarkohen komisionet ad-hoc të ngritur për shqyrtimin e dosjeve të aplikimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Prof. Rozeta Miho Mitrushi

Rozeta Miho
Rozeta